

**LAURA SMAQI**

**HAXHIADEMI DHE PROCESI LETRAR  
SHQIPTAR I VITEVE '30  
VËSHTRIM PËRMBLEDHËS**

Periudha midis dy Luftërave Botërore vuri në dukje dy fenomene të rëndësishme në zhvillimin e letërsisë shqipe: *së pari* u synua të mbushen me sa ishte e mundur mungesat e shumta. Autorët u përpoqën të sjellin kontribut duke bërë të njohur sa emrin e tyre, ashtu edhe aspekte të palëvruara të letërsisë në të gjitha gjinitë: prozë, dramë, kudo. *Së dyti*, shkalla e përpunimit të gjuhës poetike shkoi nga përmirësimi i ndjeshëm në krahasim me periudhat pararendëse, drejt niveleve të cilat mund të konsiderohen kulme në historinë e zhvillimit të letrave shqipe.

Po të ndalemi në aspektin e parë, Haxhiademi është një nga shembujt e fenomenit. Tragjeditë e tij janë së pari kontribut në fushën e gjinisë, duke qenë se gjatë viteve '20 janë vënë në skenë komedi, drama ose melodrama, shumë më pak vepra tragjike, përmes të cilave në radhë të parë vihet theksi, spikat synimi e dëshira për të krijuar një fizionomi të kësaj gjinie. Të shkruara nga mesi i viteve '20 ('24-'28), tragjeditë e para synojnë të sjellin një gjini që mungon në letrat shqipe, ose dhe kur ka ekzistuar ka qenë ose përshtatje, ose larg frymës së pjesëve klasike.

Komedia e trajtuar jo pak prej Floqit në vitet '20 ishte pjesë e jetës së përditshme, lidhej më shumë me realitetin dhe me modelet që ndikonin drejtpërdrejt tek shikuesit, pa synuar ndonjë nivel të lartë artistik. Gjatë viteve '20, Kristo Floqi botoi gjashtëmbëdhjetë komedi me një akt dhe operetën *Qerthulli*

*politik*<sup>1</sup>. Të gjitha komeditë dhe farsat u vunë me sukses në skenë në qytete të ndryshme, gjatë gjithë periudhës së viteve '20, për vetë problematikat shoqërore dhe situatat gazmore që vinin në fokus. Herë viheshin në qendër dukuri, herë vese njerëzore. Në grupin e parë përmendim pjesët *Rrogat e nëpunësve*<sup>2</sup>, *E mbesa e krahinarit*<sup>3</sup>, *Akraballëkët*<sup>4</sup>, në grupin e dytë *Vllazni e interesë*<sup>5</sup>, *Kundërshtarët e prikës*<sup>6</sup>, *Dhëndër me përdhuni*<sup>7</sup> etj.

Opereta, është konceptuar në nëntë kapituj, ku satirizohen dukuri të ndryshme komike në nëntë fusha të ndryshme shoqërore. Nga parlamentarët, qeveritarët që shkelin Kushtetutën, nga mbizotërimi i interesave klanore, marrja e funksioneve nga njerëz të paditur e pa shkollim, i gjithë qerthulli funksionon në mënyrë perfekte në dëm të Shqipërisë dhe të përparimit të saj.

Trilogjia e H. Stërmillit, me titujt *Dibrania e mjerueme*<sup>8</sup>, *Dashuni dhe besniki*<sup>9</sup> dhe *Agimi i lumnueshëm*<sup>10</sup> evokon qëndresën e kosovarëve dhe të dibranëve ndaj masakrave serbe. Të tria pjesët krijojnë një vepër unike nga tema, personazhet dhe ngjarjet. Temat e qëndresës dhe dashurisë ndërthuren. Shkatërrimi i lumturisë prej pushtimit, vuajtjet që vijnë prej tij, shpresa e mbërritjes së lirisë, të gjitha këto i bëjnë dramën mjaft komunikuese me spektatorin.

<sup>1</sup> K. Floqi, *Qerthulli politik*, Shtypshkronja Tirana, Tiranë, 1922.

<sup>2</sup> K. Floqi, *Rrogat e nëpunësve*, Shtypshkronja "Mbrothësia", Tiranë, 1923.

<sup>3</sup> K. Floqi, *E mbesa e krahinarit*, Shtypshkronja "Mbrothësia", Tiranë, 1926.

<sup>4</sup> K. Floqi, *Akraballëkët*, Shtypshkronja "Mbrothësia", Tiranë, 1926.

<sup>5</sup> K. Floqi, *Vllazni e interesë*, Shtypshkronja "Nikaj", 1920.

<sup>6</sup> K. Floqi, *Kundërshtarët e prikës*, Shtypshkronja Tirana, Tiranë, 1922.

<sup>7</sup> K. Floqi, *Dhëndër me përdhuni*, Shtypshkronja "G. Direttore et C.", 1922.

<sup>8</sup> H. Stërmilli, *Dibranja e mjerueme*, Shtypshkronja "Mbrothësija" Kristo Luarasi, Tiranë, 1923.

<sup>9</sup> H. Stërmilli, *Dashuni dhe besniki*, Shtypshkronja "Mbrothësija" Kristo Luarasi, 1923.

<sup>10</sup> H. Stërmilli, *Agimi i lumnueshëm*, Tiranë, Shtypshkronja "Tirana", 1924.

Dramat e Fishtës<sup>11</sup>, në formën e poemave dramatike, i marrin subjektet kryesisht nga Bibla dhe mitologjia greke, por krijojnë dhe situata e mjedise imagjinare, ku figurat e njohura tipike të mitologjisë shqiptare janë pranë përkatëseve të mitologjisë greke. Historitë biblike, mitologjike apo krijimet që janë krejtësisht frut i trillit poetik, herë kanë synim didaktik, herë vihen në funksion të ndriçimit të ngjarjeve të kohës, ose lidhen me aspekte të ndryshme të realitetit. Në mënyrë të veçantë tragjedia *Juda Makabe*<sup>12</sup>, më e realizuara në aspektin dramaturgjik, megjithë subjektin mitologjik, kërkon të prekë një varg problemesh, dhe sidomos t'i bëjë spektatorët dhe lexuesit të reflektojnë mbi sakrificën e idealit dhe tradhtinë, mbi qëndresën dhe dashurinë për atdheun.

Pjesët dramatike të Fishtës, Stërmillit, ishin vepra që kishin parasysh kryesisht spektatorin jo dhe aq publikun lexues, ndërsa me Haxhiademin shfaqet vëmendja maksimale në vepra (pjesë) që jo vetëm vihen në skenë, por edhe lexohen.

Synimi është të lihet një lloj dëshmie që në gjuhën shqipe krijohen tragjedi, në të cilat edhe kur ngjarjet mbështeten në periudha të caktuara të historisë shqiptare, përsëri kjo bëhet duke ndjekur ligjet e krijimit letrar, jo aspektet utilitare apo synimet që ato t'i shërbejnë publikut për të njohur këtë të shkuar ose për t'u ndikuar prej saj. Aspekti utilitar i drejtpërdrejtë i letërsisë së mëparshme, nuk shfaqet tek Haxhiademi. Pavarësisht se ai

---

<sup>11</sup> Në dhjetëvjetshin e parë të shek. XX Fishta ka shkruar melodramat: *Sh'Françesku i Asizit*, 1909, botuar më 1912, *Shqyptari i gjydetnuem*, Shkodër, 1911. Gjatë periudhës 1920-1941 shkroi, melodramat *Baritë e Betlemit*, në vëllimin *Vallja e Parrizit*, Shkodër, Shtypshkronja Franciskane, 1925; *Sh. Luigji Gonzaga*, Shtypshkroja e Zojës së Papërlyeme, Shkodër, 1927; *Shqyptarja e gjydetnueme*, Shtypshkroja Françeskane, Shkodër, 1929; tragjedinë *Ifigenia n'Aulli* dhe dramën *Odisea*, Shtypshkronja Françeskane, Shkodër, 1931; melodramën *Jerina ase Mbretnesha e luleve*, Shtypshkronja Françeskane, Shkodër, 1941.

<sup>12</sup> Gj. Fishta, *Juda Makabe*, Shtypshkronja Françeskane, Shkodër, 1920.

dëshiron të përmendë që veprat e marrin “shkasin”, shtysën nga ngjarje apo venë në qendër figurat tona historike, duhet thënë se *Aleksandri*<sup>13</sup>, *Diomedi*<sup>14</sup> apo *Pirrua*<sup>15</sup>, pavarësisht emrit që kanë, nuk janë pjesë e historisë së preکشme si të lexuesit dhe të spektatorit. Ndryshe është Skënderbeu, një figurë shumë popullore, pjesë e historisë, e kujtesës dhe e vetëdijes sonë, shumë më tepër se Pirroja e aq më pak Aleksandri.

Mes tragjeditive të periudhës së dytë, që i takojnë mesit të viteve '30, krahas aspektit formal të përsosjes së tragjedisë, synimi është dhe aspekti moral dhe ai i edukimit, i cili sa vjen e theksohet. Duket se me përsosjen strukturore të pjesëve vjen dhe dëshira për të kontribuar në mjedisin letrar përmes ideve, jo thjesht përmes strukturës e përsosjes së saj.

Dramat politike, *Skënderbeu*<sup>16</sup>, *Diomedi* rikthejnë çështjen e tradhtisë, temë gati qendrore e një letërsie disi më periferike të periudhës, por që tek Haxhiademi trajtohet nga një tjetër këndvështrim. Në një përjasje me dramën pararendëse *Trathëtia*<sup>17</sup> të Mehdi Frashërit, shihet se të dyja kanë elemente të përbashkëta por më shumë ndryshime. E përbashkëta është çështja e tradhtisë që e kanë të dy veprat në qendër, sado që njëri si personazhe merr Moisiun dhe Hamzain e tjetri Aranitin. Ajo që ndryshon në thelb është gjuha dhe trajtimi poetik. Gjuha tek Frashëri është jo vetëm shumë e drejtpërdrejtë, por është një gjuhë e folur, gati agjitative në pjesë të caktuara, jo fort e përpunuar. Tek Haxhiademi gjuha është poetike, është poezi me karakteristikat tipike metrike, shtojmë këtu faktin që Skënderbeu siç konsiderohet me të drejtë, mendim që mbështesim dhe ne,

<sup>13</sup> E. Haxhiademi, *Aleksandri*, Shtyp “Kristo P. Luarasi”, Tiranë, 1931.

<sup>14</sup> E. Haxhiademi, *Diomedi*, Shtëpia botonjëse “Kristo Luarasi”, Tiranë, 1936.

<sup>15</sup> E. Haxhiademi, *Pirrua*, Shtëpia botonjëse “Luarasi”, Tiranë, 1934.

<sup>16</sup> E. Haxhiademi, *Skënderbeu*, Shtëpia botonjëse “Kristo Luarasi”, Tiranë, 1935.

<sup>17</sup> M. Frashëri, *Trathëtia*, Shtypshkronja Kristo.O.Luarasi, Tiranë, 1920.

është vepra më e realizuar përsa i takon trajtimit psikologjik dhe retorik të personazheve, është shumë më komplekse se *Trathëtia*.

Tema e tradhtisë, e pranishme në të dy veprat, siç e përmendëm është pjesë e një linje që vijon nga 1924-a deri më 1935-ën (kujtojmë *Kthimin e Skënderbeut në Krujë*<sup>18</sup>, të Llambi Dardhës) dhe rishfaqet në 1944-ën (me romanin e Andon Frashërit *I funtmi i Kastriotëve*<sup>19</sup>), ndoshta e lidhur me një tjetër kontekst shoqëror dhe politik. Luftërat për pushtet dhe tradhtinë i kemi të pranishme dhe tek *Diomedi*, i cili sa është pranë *Skënderbeut* përsa i takon atmosferës së luftërave politike, aq lidhet edhe me tragjedinë pasuese *Abelin*, në aspektin e vëllavrasjes.

Një arritje e veçantë e Haxhiademit që vihet re më shumë tek *Skënderbeu* është këndvështrimi apo aftësia për t'i paraqitur e trajtuar të gjitha këndvështrimet e ndryshme sipas linjave të veçanta psikologjike. Nuk ka skematizëm, apo qëndrime që nuk burojnë nga vetë natyrat e personazheve. Secili prej tyre mban linjën e tij dhe mënyra se si e paraqesin qoftë idenë dhe pozicionin, ashtu dhe qëndrimin është i mirëpërcaktuar, ashtu siç janë dhe shprehjet që thotë gjithsecili apo mënyra e argumentimit, të gjitha i përshtaten çdo personazhi. Shkalla e vërtetësisë psikologjike është nga më të lartat, aq sa mund të flitet për një lloj “realizmi” (në aspektin e mungesës së skematizmit), megjithëse drama është klasike. Retorika e ligjërimit të çdo personazhi, mënyra se si ai formulon pozicionin e tij, mënyra se si synohet bindja e kundërshtarit, janë të gjitha në këndin e duhur, pa krijuar mospërkitje. Krijohet një shumësi qasjesh të së njëjtës ngjarje, një histori e vetme shihet nga shumë këndvështrime dhe mënyra se si ky këndvështrim arsyetohet është përsëri në linjën “realiste” që arsyetohet më lart.

---

<sup>18</sup> Ll. Dardha, *Kthimi i Skënderbeut në Krujë*, Shtypshkronja “Pepo & Marko”, Korçë, 1929.

<sup>19</sup> A. Frashëri, *I funtmi i Kastriotëve*, Ismail Mal’Osmani, Tiranë, 1944.

Parathënia e *Abelit*<sup>20</sup> na nxit drejt një vargu përsiatjesh. Pavarësisht se autori e quan tragjedi edukimi, që ka në thelb trajtimin e pabarabartë të fëmijëve nga prindërit, duhet pasur parasysh se në kuptimin e drejtpërdrejtë ajo i takon më shumë karakterit universal, jo dhe aq mjedisit shqiptar. E themi këtë sepse tek ne, përgjithësisht, diferencimi nga ana e prindërve nuk është bërë dhe aq mes dy djemve, por mes djalit dhe vajzës, gjë që historia konkrete biblike nuk e ka.

Gjithsesi, duke nisur nga historia biblike mund edhe të mendohet mbi diferencën në edukim të djalit dhe vajzës, sado që merr tjetër kuptim, duke qenë se vështirë të çojë në konflikte ekstreme. Diferenca e edukimit dhe dashurisë mes djalit dhe vajzës, e lidhur me mentalitetin shqiptar ka tjetër aspekt falë pranisë së elementit femëror, që gjithmonë konceptohet si pjesa njerëzore që gjithmonë duhet të falë e të dhurojë. Mjedisi familjar shqiptar nuk i përgjigjet dhe aq asaj që Haxhiademi e quan si problem moral, për pasojë thelbi i kësaj vepre dhe jo vetëm i saj anon nga universaliteti dhe jo realiteti shqiptar. Vëllavrasja si gjakmarrje është një kuptim i shtuar, por që i largohet kontekstit të drejtpërdrejtë familjar të ngjarjes biblike dhe asaj të tragjedisë. Qasja universale e diferencon në parim Haxhiademin nga autorë të tjerë që patën parasysh karakteristika tipike të realitetit shqiptar. Në veprat e tyre gjithçka lidhet me këtë veçanti, me specifikën që ka në vetvete. Nga ana tjetër, pikërisht se lidhja me mjedisin nuk ishte e fortë në pjesën më të madhe të tragjedisë të tij, pozicioni i Haxhiademit u konsiderua anakronik nga një pjesë e kritikës, qëndrim që lidhej si me gjininë edhe me problematikën. Në rast se do të bashkohej gjinia me një problematikë më aktuale ose më të prekshme, siç ndodhte në dramën atdhetare me thirrje patriotike, që synonin ndikimin sa më të madh të publiku gjatë Rilindjes deri në vitet '20, kritika për anakronizëm do të ishte

---

<sup>20</sup> E. Haxhiademi, *Abeli*, Shtyp. "Luarasi", 1939.

shumë më e zbutur, por niveli artistik i veprave do të çalonte dukshëm.

E reja që sjell Haxhiademi është pikërisht distancimi nga mjedisi dhe problematikat aktuale, siç e vumë në dukje që në hyrje të parashtrimit. Në një kuptim të caktuar mund të lidhet me Lasgushin përse i takon shkëputjes që të dy kanë prej problematikave aktuale, aspekteve të rëndësishme të jetës së kohës.

Të shkruaje në modelin klasik si në poezi dhe në dramë në vitet '30 konsiderohej për një pjesë të kritikës largim nga problemet e rëndësishme të realitetit, që prisnin zgjidhje. Një qëndrim i tillë i kritikës lindte ngaqë ajo merrte parasysh publikun masiv, jo spektatorin apo lexuesin e kultivuar që di ta shohë vetveten në çdo ngjarje që sheh në skenë, dhe e ka pjesë të jetës së tij leximin, pavarësisht tematikës. Një pjesë e këtij publiku dhe lexuesi të kohës, ndonëse jo masiv, ka mundur ta receptojë në të gjitha qasjet Haxhiademin.

Në lidhje me përpunimin e shqipes në trajta klasike, një pozicion të fortë miratues ka mbajtur Koliqi, i cili në artikullin “Mbi vargje klasike e të lira”, botuar më 1934, në “Gazetën shqiptare”, thekson domosdoshmërinë e realizimit të veprave poetike në trajtën klasike pavarësisht akuzave për anakronizëm. Ndryshe nga qëndrimet të cilat theksonin se letërsia duhet të merrte një pozicion, duhet të luante një rol të rëndësishëm për të ndihmuar në zgjidhjen e problemeve të kohës, për Koliqin (ashtu si dhe për Haxhiademin) shkrimi në trajtat klasike është i domosdoshëm për arsye të nevojës që ka gjuha shqipe për t'u lëvruar në këto trajta, ndryshe nga letërsitë e mëdha, të cilat, falë zhvillimit historik disa shekullor dhe falë trajtimit të tepruar të shtrëngesave metrike, e kishin të nevojshme prishjen e metrit apo daljen nga rregullat karakteristike metrike. Sipas autorit, letërsia dhe gjuha shqipe duke mos qenë të lëvruara, mund të arrinin realizime me mjaft nivel artistik duke u shtrënguar, duke u detyruar t'i përshtaten metrave klasikë. Synimi apo rëndësia që

Koliqi i ve letërsisë në këtë aspekt është theksuar dhe është mbështetur nga revista *Leka* dhe nga përfaqësues të dy shkollave letrare shkodrane.

Për të mbetur sërish te këta dy autorë, një tjetër paralele mund të hiqet mes parathënies së *Lyrës*<sup>21</sup> dhe “Auto-da-fesë” së *Gjurmave të stinve*<sup>22</sup>. *Gjurmat e stinve* janë botuar më 1933, natyrisht edhe “Auto-da-feja”, si parathënie e vëllimit i takon kësaj date, pasi nuk është botuar diku tjetër më parë. Parathënia e *Lyrës* është shkruar më 1937-n gjë që nënkupton se parathënia e Koliqit ka qenë bazë apo pararendëse e *Lyrës*. Në qoftë se do t’i krahasojmë të dyja, do të shohim disa elemente të përbashkëta: të dy autorët vënë në dukje veçantinë apo problematikën që ka shkrimtari shqiptar në një mjedis ku puna poetike nuk vlerësohet dhe kujtojnë periudhat e lashta kur puna e poetit vlerësohej. (Mbretërit dhe njerëzit e mëdhenj të shteteve merrnin pranë vetes poetë të cilët përmes krijimeve të tyre lartësonin këta udhëheqës dhe populli i nderonte.)

Po ashtu psikologjia shqiptare në lidhje me një veprimtari krejtësisht të padobishme e jo përfituese siç është krijimtaria artistike, përmendet nga të dy autorët. Koliqi e ka shumë poetik konceptimin e parathënies. Duke i vënë dhe një titull, ai ndjek figurativisht të gjitha hapat që një Auto-da-fe nënkupton: dëshmon, mohon derisa djeg veprat e veta, ndërsa parathënia e “Lyrës” është shumë më modeste. Po ashtu përfundimi i shtjellimit është i ndryshëm përderisa Koliqi “i djeg” veprat, ndërsa Haxhiademi i konsideron si kontribut për zhvillimin e letërsisë së varfër shqipe.

Megjithë qasjen disi të ndryshme në aspektin poetik, të dy autorët nuk i shpëtuan dot dënimit politik, pas Luftës së dytë. Për Haxhiademin kalvari qe shumë më i rëndë se për sivëllezërit e tij

<sup>21</sup> E. Haxhiademi, *Lyra*, Shtyp. “Dielli”/ “Luarasi”, Tiranë, 1939.

<sup>22</sup> E. Koliqi, *Gjurmat e stinve*, Shtyp. Shkodra, Tiranë, 1933.

“dashunorë të Zanave”, që u larguan nga Shqipëria. Torturat dhe burgu, e bënë krijuesin të përjetojë shumë më tepër nga ç’kishin ndjerë heronjtë e tij madhështorë, e bënë ta jetojë tragjedinë në më të thellat përmasa të saj. Ndoshta historia e tij, dhimbjet e parrëfyera dhe përjetimet do të ishin subjekti i tragjedisë më moderne, të cilën klasiku do ta kishte të pamundur ta shkruante.

Procesi letrar i viteve '30 e sheh Haxhiademin si zërin klasik brenda një shumësie prirjesh e tendencash, të cilat për fat të keq pas mesit të viteve '40 do të shkojnë drejt varfërimit, unifikimit të njëzëshëm dhe përjashtimit të mjaft vlerave të së shkuarës. Veçantia e veprave do të bëjë që të njihet si themelues dhe pjesët e tij klasike të mbeten ishullore në letërsinë shqipe.

## BIBLIOGRAFI

Dardha, Ll., *Kthimi i Skënderbeut në Krujë*, Shtypshkronja “Pepo & Marko”, Korçë, 1929.

### Fishta, Gj.,

*Shqyptari i gjytetnuem*, Shkodër, 1911.

*Sh'Françesku i Asizit*, Shkodër, 1912.

*Juda Makabe*, Shtypshkronja Françeskane, Shkodër, 1920.

*Baritë e Betlemit*, në vëllimin *Vallja e Parrizit*, Shkodër, Shtypshkronja Franciskane, Shkodër, 1925;

*Sh. Luigji Gonzaga*, Shtypshkronja e Zojës së Papërlyeme, Shkodër, 1927;

*Shqyptarja e gjytetnueme*, Shtypshkronja Françeskane, Shkodër, 1929;

*Ifigenia n'Aulli dhe Odisea*, Shtypshkronja Françeskane, Shkodër, 1931;

*Jerina ase Mbretnesha e luleve*, Shtypshkronja Françeskane, Shkodër, 1941.

**Floqi, K.,**

*Qerthulli politik*, Shtypshkronja Tirana, Tiranë, 1922.  
*Rrogat e nënpunësve*, “Mbrothësia”, Tiranë, 1923.  
*E mbesa e krahinarit*, “Mbrothësia”, Tiranë, 1926.  
*Akraballëkët*, “Mbrothësia”, Tiranë, 1926.  
*Vllazni e interesë*, Shtypshkronja “Nikaj”, 1920.  
*Kundërshtarët e prikës*, Shtypshkronja Tirana, Tiranë, 1922.  
*Dhëndër me përdhuni*, Shtypshkronja “G. Direttore et C.”, 1922.

**Frashëri, M.,**

*Trathëtia*, Shtypshkronja Kristo.O.Luarasi, Tiranë, 1920.

**Frashëri, A.,**

*I funtmi i Kastriotëve*, Ismail Mal’Osmani, Tiranë, 1944.

**Haxhiademi, E.,**

*Ulisi*, Shtëpia botonjëse “Kristo Luarasi”, Tiranë, 1931.  
*Akili*, Shtëpia botonjëse “Kristo Luarasi”, Tiranë, 1931.  
*Aleksandri*, Shtyp “Kristo P. Luarasi”, Tiranë, 1931.  
*Diomedi*, Shtëpia botonjëse “Kristo Luarasi”, Tiranë, 1936.  
*Pirrua*, Shtëpia botonjëse “Luarasi”, Tiranë, 1934.  
*Skënderbeu*, Shtëpia botonjëse “Kristo Luarasi”, Tiranë, 1935.  
*Abeli*, Shtyp. “Luarasi” 1939.  
*Lyra*, Shtyp. “Dielli”/ “Luarasi”, Tiranë, 1939.

**Stërmilli, H.,**

*Dibranja e mjerueme*, Shtypur ndë Shtypshkronjët “Mbrothësija” Kristo Luarasi, Tiranë, 1923.  
*Dashuni dhe besniki*, Shtypur ndë Shtypshkronjët “Mbrothësija” Kristo Luarasi, 1923.  
*Agimi i lumnuëshëm*, Tiranë : Shtypshkronja “Tirana”, 1924.

**Koliqi, E.,**

*Gjurmat e stinve*, Shtyp. Shkodra, Tiranë, 1933.